

A JENI TË SIGURTË QË ORGANIZATA JUAJ ËSHTË NË PËRPUTHJE ME GDPR?



RAPORT HULUMTUES
QERSHOR 2019



PËRKRAHUR NGA



REPUBLIKA E KOSOVËS
**MINISTRIA E INOVACIONIT DHE
NDËRMARRËSISË**

IMPLEMENTUAR NGA



Përmbajtja

I. Hyrje	4
Çfarë është GDPR?	5
II. Metodologjia e Hulumtimit	9
III. Rezultatet	10
IV. Konkluzioni	23

I. Hyrje

Me hyrjen në fuqi të rregullores për GDPR (General Data Protection Regulation) nënkuptohet që të gjithë ata të cilët trajtojnë të dhënat personale të qytetarëve të BE-së, janë të obliguar që të zbatojnë këtë rregullore në plotësi.

Në të kundërtën, gjoba për mos-pajtueshmëri mund të arrijë deri në 20 milionë euro apo 4% të qarkullimit vjetor¹.

Mala ACG e përkrahur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ka realizuar këtë hulumtim i cili ka të bëjë me paraqitjen e gjendjes së zbatimit dhe gatishmërisë për pajtueshmëri me GDPR nga kompanitë vendore.

Rezultatet e kësaj ankete do të gjenerojnë një raport përfundimtar që mund të shërbejë për të:

- a. Ngritur vetëdijesimin për rëndësinë e kësaj rregulloreje dhe zbatimi i saj
- b. Përkrahur zbatimin në plotësi të kërkesave nga GDPR

Afati i pajtueshmërisë së Rregullores së BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të BE-së (GDPR) të 25 majit 2018 ka kaluar dhe pyetja në mendjet e të gjithëve është - si ia kemi bërë? A ishin kompanitë vendore Kosovare në gjendje të arrijnë pajtueshmërinë tani që nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje?

Sa kanë shpenzuar për përpjekjet e tyre për pajtueshmëri? Cilat ishin sfidat më të mëdha të zbatimit të GDPR-së dhe a kishin nevojë për ndihmë dhe burime të jashtme për të përmbushur këto sfida? Çka i ka motivuara këto kompani të për tu bere te përputhshme me GDPR?

Për të ndihmuar në gjetjen e përgjigjeve për këto pyetje, Mala ACG realizoi anketën, të emëruar “A JENI I SIGURT QË ORGANIZATA JUAJ ËSHTË NË PËRPUTHJE ME GDPR?”

Kjo anketë është shpërndarë me ane të rrjeteve sociale, emailat e dërguar në mënyrë direkte, me ane të shoqatave të ndryshme të cilat veprojnë në vendin tonë, si dhe e publikuar në faqen tonë.

Gjithsej, 57 kompani/organizata i janë përgjigjur në plotësi pyetjeve kryesore të anketës.

Kompanitë pjesëmarrëse përfshinin një përzierje të kompanive të vogla, të mesme dhe të mëdha, nga të gjitha sektorët kryesorë të industrisë.



Çfarë është GDPR?

Më 25 maj 2018, Rregullorja Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave (General Data Protection Regulation – GDPR) ka hyrë në fuqi dhe mospërputhja mund t’u kushtojë kompanive një shumë të madhe. Kjo do të ndryshojë mënyrën se si bizneset dhe organizatat e sektorit publik merren me informacionin e klientëve.

Premisa e rregullores është që të mbrojnë të dhënat personale dhe privatësinë e individëve për transaksionet që ndodhin brenda shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE). Ai gjithashtu rregullon shkëmbimin e të dhënave personale jashtë BE-së.

Një gjë që kompanitë jashtë BE duhet të marrin parasysh, duke përfshirë edhe kompanitë Kosovare, është se Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave do të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha bizneset që tregojnë ose bëjnë biznes me shtetet anëtare apo qytetaret e Bashkimit Evropian, pavarësisht se ku ndodhet biznesi në botë.

GDPR është zhvilluar për të mbrojtur të dhënat personale të qytetarëve të BE-së dhe mënyrën se si ato grumbullohen, ruhen, përpunohen, përdoren dhe madje shkatërrohen nëse nuk do të përdoren më. Legjislacioni u krijua për t’i dhënë qytetarëve kontroll mbi të dhënat e tyre personale.

Të dhënat personale përfshijnë adresat IP, të dhënat e vendndodhjes dhe identifikuesit në internet. Të dhënat personale të ndjeshme përfshijnë të dhëna biometrike dhe gjenetike. Pika të tjera përfshijnë pëlqimin e prindërve të nevojshëm për përpunimin e të dhënave të fëmijëve, transferimin e të dhënave ndërkufitare, si të parandalojnë shkeljet e të dhënave dhe udhëzimet strikte për njoftimin e shkeljes së të dhënave kur ato ndodhin.

Ai gjithashtu përfshin informacione të kërkuara në mënyrë rutinore nga faqet e internetit, duke përfshirë adresat IP dhe adresat e-mail, informacionin e pajisjeve fizike siç është adresa MAC e kompjuterit, adresat e shtëpive të individëve, datat e lindjes dhe informatat financiare në internet, duke përfshirë historitë e transaksioneve online.

Megjithatë, kjo nuk është e gjitha që GDPR synon të mbrojë. Legjislacioni gjithashtu mbron të dhënat e krijuara nga përdoruesit, të tilla si mesazhet në media sociale (duke përfshirë tweetet individuale dhe përditësimet e Facebook), si dhe imazhe personale të ngarkuara në ndonjë faqe interneti, duke përfshirë ato që nuk shfaqin ngjashmërinë e personit që ka ngarkuar imazhin. GDPR gjithashtu mbulon të dhënat mjekësore dhe informacione të tjera unike, të cilat zakonisht

TË DHËNA TË MBROJTURA

- IP adresa dhe adresat e emailit
- Informacionin e pajisjeve fizike të tilla si MAC-adresa e një pajisje kompjuterike
- Adresat e shtëpisë të individëve
- Datat e lindjes
- Informacion online financiar
- Historitë e transaksioneve online
- Të dhënat mjekësore
- Besimi fetare, filozofike ose politike
- Seksualiteti ose orientimi seksual
- Të dhëna gjenetike ose biometrike duke përfshirë shenjat e gishtërinjve dhe ADN-në
- Të dhënat e krijuara nga përdoruesit, të tilla si mesazhet e mediave sociale
- Fotot personale të ngarkuara në ndonjë faqe interneti
- Çdo informacion tjetër unik personal zakonisht i transmetuar në internet.

transmetohen në internet.

Në thelb, GDPR mbron çdo dhe të gjithë të dhënat personale të përdoruesve në pothuajse çdo platformë të mundshme online.

Sipas GDPR, kompanitë duhet të kalojnë nga një qasje opt-out në një qasje opt-in. Kjo është – në vend se t'i jepet përdoruesve një mundësi për të zgjedhur të dhënat e mbledhura dhe të ruajtura, përdoruesit duhet paraprakisht të japin leje për të mbledhur dhe përdorur të dhënat e tyre. Kjo vlen për gazetatat dhe platformat e tjera ku të dhënat e tyre mund të mblidhen.

Përdoruesit evropianë kanë të drejtën ligjore për të pyetur ose apeluar se si paraqiten informacionet e tyre personale nga algoritme të tilla si ato të përdorura nga bizneset e kërkimit dhe të ngjashmit.

Fillimisht, organizata/kompania duhet të vlerësojë qëllimin dhe kohëzgjatjen e mbledhjes së të dhënave të nevojshme për të arritur qëllimin e mbledhjes së të dhënave, ruajtjen dhe deponimin e tyre, bartjen e tyre tek ndonjë kompani, organizatë apo edhe institucion publik, si dhe shkatërrimin e këtyre të dhënave pas realizimit të qëllimit fillestar për mbledhjen e tyre. Në vazhdimësi, kompania duhet vlerësuar kapacitetet e nevojshme teknike për të realizuar këtë proces, pasi që lirisht mund të themi se do të ndryshojë rrënjësisht operimi i sistemeve të tyre. Do të ndryshojë mënyra e pasqyrimin të tyre në bazat e tyre të shënimeve; do të duhej zbatuar katalogimi i të gjitha të dhënave; duhet përcjell qasjen në to dhe autorizimet e duhura; deponimin dhe ruajtjen e kopjeve rezervë etj. e shumë e shumë procese të tjera.

Këto janë disa nga proceset të cilat duhet zbatuar, por edhe dokumentuar në mënyrën e duhur, pasi që do të kërkohet që të dëshmojnë masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të këtyre të dhënave personale.

Risi në GDPR është edhe mënyra e njoftimit të subjektit të të dhënave – i cili në këtë rast është personi të cilit i merren të dhënat – si dhe miratimi (eng. Consent) nga ana e tij për të trajtuar të dhënat e tij/saj.

Përveç nëse është e specifikuar me ndonjë ligj tjetër, i cili u mundëson trajtimin e të dhënave institucioneve publike në mënyrë që ato të realizojnë mandatin e tyre, i cili ka të beje bëjë me sigurinë e përgjithshme, shëndetin publik apo të ngjashme, nuk duhet kushtëzuar në asnjë mënyrë ofrimin e shërbimit apo shitjen e produkteve në rast se subjekti i të dhënave – personi – refuzon që të pranojë trajtimin e të dhënave të tij/saj.

Në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, a jeni përgjigjur duke ndjekur pyetjet në politikën tuaj të privatësisë ...

- Kush është kontrolluesi juaj i të dhënave?
 - Çfarë vendimesh bëni me të dhënat e mbledhura?
 - Cilat të dhëna po grumbulloni?
 - Për Çfarë do të përdorni këto të dhëna?
 - Sa kohë ruhen të dhënat?
 - A janë të dhënat të detyrueshme për funksionimin e shërbimit tuaj?
 - A transferoni të dhëna në nivel ndërkombëtar?
 - Kush tjetër ka qasje në të dhënat?
-

Po ashtu, njoftimi për miratim, i cili duhet t'i kumtohet në formë të shkruar apo edhe verbale subjektit të të dhënave, duhet të jetë i thjeshtë, i lexueshëm dhe i kuptueshëm për subjektin e të dhënave. Përmbajtja e këtij njoftimi duhet të jetë e kuptueshme nga të gjithë dhe mundësisht të përmbajë sa më pak terminologji juridike apo teknike. Ky miratim do të jetë i vlefshëm vetëm në rastet e pajtueshmërisë së theksuar të një akti konfirmues.

Çfarë do të thotë për bizneset jashtë BE-së?

GDPR nuk aplikohet vetëm për kompanitë në BE por edhe për kompanitë jashtë BE-së që tregtojnë mallra apo shërbime për qytetarët e BE-së. Po ashtu vlen për kompanitë që kontrollojnë ose përpunojnë të dhëna për një shtetas të BE, pavarësisht vend ndodhjes se tij apo saj.

Është e rëndësishme të theksohet se nën GDPR, të dy përpunuesit dhe kontrollorët janë përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale të qytetarëve të BE-së (përpunuesit – të dhënat e procesit në emër të një kompanie tjetër që janë kontrollorët).

Të gjitha kompanitë që bien në ato kategori duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e GDPR-së. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme – edhe për kompanitë nga vendet jo anëtare të BE – të kuptojnë dhe të përgatiten për këtë.

Nuk vërehet të jetë bërë përparësi në pajtueshmëri me GDPR

Gjetjet kyçe të hulumtimit nxjerrin në pah se 8% të kompanive të anketuara besojnë se tani janë në pajtueshmëri me GDPR! 47% ende nuk kanë filluar zbatimin e tyre, ndërsa 45% janë në fazën e planifikimit apo kanë filluar zbatimin. Ndërsa shumë kompani kanë ende shume punë për të bërë, 51% presin që të jenë në përputhje brenda një afati kohor prej 12 muajve, ndërsa pjesa tjetër beson se i duhet me shume se 12 muaj kohe për të arritur pajtueshmëri me GDPR.

Sfidat më të mëdha për të anketuarit për të arritur pajtueshmëri me GDPR përfshinin kompleksitetin e rregullores dhe mungesën e stafit të kualifikuar të brendshëm dhe ekspertizën e privatësisë që nevojitet për t'u marrë me këto kompleksitete. Në kundërshtim me pikëpamjen e përbashkët se frika nga gjobat e GDPR-së do të ishte motivuesi kryesor për kompanitë që të bëheshin në përputhje, të anketuarit në mënyrë dërmuese citonin mbështetjen e vlerave të tyre të korporatave dhe përmbushjen e pritjeve të klientëve dhe partnerëve të tyre si drejtuesit kryesorë.

GDPR – një udhëtim i kushtueshëm

Programet e përputhshmërisë së GDPR, bazuar në analiza të ndryshme ndërkombëtare kanë treguar përpjekjet për pajtueshmëri janë të kushtueshme! Sidoqoftë, hulumtimi tregon se 57% e kompanive të anketuara, kanë planifikuar që të shpenzojnë deri në 10,000 EUR, përderisa vetëm 16% kanë planifikuar

| www.mala-acg.com |

8




II. Metodologjia e Hulumtimit

Për te realizuar këtë hulumtim, kemi përpiluar anketën, e cila ka përfshirë në vete pyetje të cilat do të qartësojnë gjendjen në të cilën kompanitë vendore aktualisht ndodhen. Anketa është zhvilluar online nëpërmes platformës elektronike të quajtur SurveyMonkey. Kryesisht janë të bazuara në gjendjen apo veprimet bazike të cilat duhet të ndermirren në mënyrë që të fillohet me zbatimin e GDPR apo mirëmbahet pajtueshmëria me të.

Për shkak të rrumbullakimit, përqindjet e treguara në tabela jo gjithmonë paraqesin shumën prej 100%.

Anketa është plotësuar online² gjatë periudhës Mars-Maj 2019. Veprimtaria e kompanive të cilat i janë përgjigjur anketës, është paraqitur tek Figura .


Figura 1 - Fusha e veprimtarisë së kompanive të anketuara



Përderisa madhësia e kompanive, e prezantuar me numër të të punësuarve, është paraqitur tek Figura 2.

² <https://www.surveymonkey.com/r/MalaACGweb>

Figura 2 – Numri i të punësuarve ne kompani




III. Rezultatet

Një numër i caktuar i kompanive te anketuara janë te vetëdijshme lidhur me nevojën dhe kërkesat për arritjen e pajtueshmërisë me GDPR. Përderisa pjesa tjetër, bazuar ne përgjigjet e ofruara dëshmon mungesën e kapaciteteve apo njohurive te mjaftueshme për zbatimin e saj.

Në vazhdim do i paraqesim rezultatet e anketës, si dhe opinionin tone lidhur me përgjigjet e ofruara


Pyetja 1

Cili opsion më së miri përshkruan gjendjen e përputhshmërisë tuaj me GDPR?



47% kanë deklaruar se nuk kanë filluar ende, përderisa 18% prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë filluar, mirëpo ekziston një plan për zbatimin e GDPR. Kjo mund të jete pasoje e mungesës së informimit të kompanive lidhur me GDPR, fushëveprimin e tij, si dhe kompanitë të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me këtë Rregullore, pavarësisht që vendi ynë ende nuk është anëtar i vendeve të BE-së.

Pyetja 2




35% e te anketuareve besojnë se ju duhet më shume se 1 vit për të arritur pajtueshmërinë me GDPR, përderisa 51% prej tyre deklarojnë se ju nevojitet deri në 12 muaj që të arrihet kjo.

Varësisht nga madhësia e kompanisë, një kohe optimale për kompanitë e madhësisë mesatare të vendit tonë, do te ishte afërsisht 18 muaj.

Pyetja 3

Cilat janë arsytet tuaja kryesore për të investuar në përputhshmërinë me GDPR?




Nga kjo pyetje është interesante se të anketuarit kanë përzgjedhur 2 opsione të cilat kanë të bëjnë me reputacionin dhe plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, opsione këto të përzgjedhura nga 47% e të anketuareve, kundrejt opsioneve të tjera si vlerat e kompanisë me 45%; evitimi i gjobave dhe pritjet apo kërkesat e partnerëve me 37%; diferencimi nga konkurrenca me 33%; si dhe plotësimi i raportimit të brendshëm, me vetëm 10%.

Përqindja e vogël lidhur me opsionin për plotësimin e raportimit të brendshëm, mund të beje edhe me faktin e mungesës së njohurive të cilat mund të ndërliken edhe me auditimin e brendshëm, i cili duket se nuk kërkon realizimin e pajtueshmërisë së kompanisë me GDPR.

Pyetja 4

Cilat janë sfidat me të cilat përballeni / jeni përballur për zbatimin e GDPR?




Pa dyshim se kompleksiteti i GDPR-së është një ndër sfidat kryesore me të cilat janë përballur 47% të të anketuareve. Përderisa mungesa e njohurive apo kuptimi se çfarë duhet bërë ishte sfida me të cilën janë përballur 43% si dhe 37% kanë deklaruar se përballen me mungesë të stafit të kualifikuar. Këto 3 sfidat kryesore me të cilat janë përballur të anketuarit, ndërlidhen drejtpërsëdrejti me posedimin e njohurive, duke filluar nga njohuria apo kuptimi i kërkesave komplekse dhe ne shume raste ndoshta edhe teknike që duhet zbatuar, e deri tek mungesa e stafit apo personelit të cilët do të posedonin aftësitë e duhura për zbatimin e kërkesave për të arritur pajtueshmërinë me GDPR.

Përzgjedhje dytësore nga kjo pyetje, 25% e të anketuareve kanë deklaruar se kanë filluar tepër vonë me zbatimin e GDPR dhe kjo është arsyeja se pse ende nuk janë në pajtueshmëri të plote, si dhe 10% e tyre kanë deklaruar se buxheti i ndare është i pamjaftueshëm, qe mund te jete një indikator se udhëheqësit e larte të kompanive nuk posedojnë njohurit e duhura lidhur me obligimet që dalin nga GDPR ndaj mbrojtjes dhe trajtimit të të dhënave personale.

Pyetja 5


Përditësimi i politikave dhe procedurave sipas kërkesave të GDPR ...



Shqetësuese është deklarimi i kompanive, ku 66% apo 2/3 e tyre kanë deklaruar se ende nuk kanë filluar apo janë te planifikuara përpilimi apo përditësimi i politikave dhe procedurave sipas kërkesave të GDPR. Ky është një indikator tjetër i qeverisjes apo menaxhimit të mirëfillte nga një pjese e këtyre kompanive. Përdërisa 34% apo 1/3 kompanive kane deklaruar se janë duke zbatuar apo vetëm se kanë përfunduar me zbatimin e këtyre politikave apo procedurave.


Vendosja e politikave dhe procedurave qartazi mundëson dhe siguron një llogaridhënie të duhur si dhe qëndrueshmëri të mirëmbajtjes së pajtueshmërisë me GDPR. Në rast të mungesës së tyre veprimet mund të realizohen në baza ad-hoc dhe mund të paraqiten vështirësi në monitorimin dhe performancën e tyre.

Pyetja 6 deri ne 13




Disa nga kërkesat kyçe të GDPR kanë të bëjnë me dhënien e pëlqimit nga konsumatorët si dhe menaxhimin dhe trajtimin e këtyre kërkesave. Nga grafiku i paraqitur më larte, është bërë përmbledhje nga pyetja 6 e deri tek ajo 13 për shkak te natyrës së ngjashme të tyre që kanë të bëjnë me disa nga kërkesat kyçe. Duhet të rikujtojmë se menaxhimi dhe trajtimi i pëlqimit është një nga qëllimet kryesore të GDPR dhe si të tilla, konsumatori fillimisht duhet të japë pëlqimin e tij, të ketë mundësi që t'i korrigjoj apo fshijë ato, si dhe te ketë të drejte në informata se kush dhe për çfarë arsye është qasur në të dhënat e tij apo saj personale.

Pyetja 6 deri ne 13 mesatarisht



Ne rast të paraqitjes së mesatarës për këto kërkesa kyçe, do të vërejmë se vetëm 9% të të anketuareve në mesatare kanë deklaruar se janë në pajtueshmëri të plotë, përderisa 10% e tyre janë duke i zbatuar ato dhe zbatimi po ecën mirë, apo 11% se zbatimi i tyre sapo ka filluar. Përderisa 69% kanë deklaruar se ato janë të planifikuara apo nuk kane filluar ende.

Pyetja 14




Kërkesë tjetër e rëndësishme e GDPR është edhe trajnimi apo vetëdijësi i punëtorëve të kompanisë, ku vetëm 10% e të anketuareve tonë kanë deklaruar se janë në pajtueshmëri të plotë dhe 10% se zbatimi po ecën mirë. Përderisa 72% e tyre kanë deklaruar se ende nuk kanë filluar apo vetëm janë të planifikuara.

Mungesa e trajnimit dhe vetëdijësit të personelit të brendshëm të kompanisë nuk mund të sigurojë se politikat dhe proceset e punës janë duke u respektuar dhe si të tilla mund të sjellin shkelje apo mos përshtatje me GDPR.


Po ashtu ne rastet kur nevojitet bartje apo transferim i të dhënave në vendet e tjera, duhet të jenë të mirë vendosura mekanizmat për mbikëqyrjen e këtyre transferimeve ndërkombëtare.

Pyetja 15



72% e të anketuareve kanë deklaruar se ende nuk kanë filluar apo janë të planifikuara për zbatim këta mekanizma.


Pyetja 16



Disa nga proceset kyçe që duhet zbatuar kompanitë sipas kërkesave të GDPR kanë të bëjnë edhe me të dhënat të cilat i mbledhin nga konsumatorët e tyre si dhe trajtimi i tyre. Për të qenë sa më efikas, kompanitë duhet të vlerësojnë fillimisht qëllimin dhe natyrën e të dhënave të cilat i mbledhin, pasi që sa më shumë të dhëna që mbledhin aq më i vështirë dhe kompleks do të jetë edhe menaxhimi i tyre, andaj ato duhet që të mbledhin vetëm ato të dhëna të cilat janë të nevojshme për ofrimin e shërbimit apo produktit për konsumatorin. Po ashtu këto të dhëna, gjatë deponimit apo transmetimit të tyre duhet që të jenë të enkriptuara, në mënyrë që qasja në to të mos jetë e hapur dhe të cenohet integriteti apo fshehtësia e tyre.

29% e kompanive kanë deklaruar se realizojnë enkriptimin e të dhënave. 25% prej tyre kanë deklaruar se realizojnë minimizimin e të dhënave, 24% se kanë të vendosura mekanizmat apo mjetet për rikuperim nga fatkeqësitë. 18% kanë realizuar teste të ndryshme të sigurisë dhe 12% prej tyre realizojnë pseudonimizimin e të dhënave, në mënyre që ato mos të mund të identifikojnë subjektin apo personin në fjalë, në rastet kur këto të dhëna duhet përpunuar apo ndarë me njësi, kompani apo vende të tjera. 49% kanë deklaruar se nuk realizojnë asnjërin nga proceset kyçe të lartpërmendura.

Pyetja 17-18




Nga pyetjet lidhur me planifikimin dhe shpenzimin buxhetor lidhur me zbatimin e GDPR, një numër i konsiderueshëm i tyre ka deklaruar se nuk kanë shpenzuar apo planifikuar asgjë! Ky mund të jete një indikator i mungesës së informimit për rëndësinë dhe obligimet lidhur me trajtimin e të dhënave personale.

Ndikimi i GDPR ndaj bizneseve është vlerësuar kryesisht si pozitiv


Përkundër shqetësimeve nga kompanitë lidhur me kompleksitetin dhe mungesën e njohurive apo aftësive të duhura, apo edhe mos fillimin ende të zbatimit të saj, 67% e të anketuareve, ndikimin e GDPR e vlerësojnë si pozitiv, 29% kanë vlerësim neutral, ndërsa vetëm 4% e konsiderojnë atë si ndikim negativ.

Pyetja 19




Lidhur me pyetjen se për zbatimin e cilave fusha keni shfrytëzuar kompani të jashtme apo ofrues të shërbimeve për të ju ndihmuar të plotësoni kërkesat për pajtueshmëri me GDPR, 63% e kompanive të anketuara kanë deklaruar se nuk kanë përdorur ndihmë nga jashtë, përderisa nga 8% janë deklaruar për qartësim të rregullores dhe zhvillimin e politikave. 20% prej tyre kanë investuar në trajnimin dhe edukimin e personelit të tyre, përderisa 20% kane investuar në mjetet dhe teknologji për realizimin e proceseve të tyre.

Pyetja 20




Të anketuarit kanë deklaruar se përdorin zgjedhje të ndryshme për të përkrahur programin e tyre. 33% prej tyre kanë të zhvilluara sisteme përbrenda kompanisë së tyre, 10% përdorin mjete apo softuerë të ndryshme pa pagesë të llojit 'open source', ndërsa vetëm 3% përdorin softuerë për Qeverisje, Risk dhe Pajtueshmëri (GRC).

Pyetja 21




Pyetja 22




87% e të anketuarve besojnë se menaxhimi i privatësisë së të dhënave në kompanitë e tyre do të bëhet më i rëndësishëm, 12% besojnë se nuk do të ndryshojë rëndësia, përderisa 2% besojnë se do të bëhet më pak e rëndësishme.

Pyetja 23




Ndërsa të anketuarit bëhen të pajtueshëm me GDPR dhe hyjnë në fazën e menaxhimit të vazhdueshëm, ata synojnë të mbështeten më shumë në teknologji, me 78% që rritin investimet në teknologji dhe mjete për të përkrahur përpjekjet e tyre për pajtueshmërinë e vazhdueshme me GDPR. 16% kanë deklaruar se posedojnë mjetet e duhura, ndërsa 6% nuk planifikojnë të zbatojnë asnjë mjet.

Pyetja 24



Përgjatë 12 muajve të ardhshëm, 37% e kompanive kanë deklaruar se mirëmbajtja dhe demonstrimi i pajtueshmërisë do të jenë të një rëndësie të veçantë. Përderisa 35% do të synojnë arritjen e pajtueshmërisë. 22% prej tyre do synojnë pajtueshmërinë me standarde të ndryshme apo rregullore të tjera rajonale apo shtetërore.


Pyetja 25



6% e të anketuarve kanë deklaruar se përgjatë kësaj ankete janë njoftuar për here të pare lidhur me GDPR. 12% janë njoftuar nga shoqatat/odat vendore, organet shtetërore, apo përgjatë konferencave apo punëtorive në të cilat ishin pjesëmarrës. Ky numër i vogël dëshmon mungesën e iniciativave të ndryshme për ngritje të vetëdijesimit tek komuniteti i bizneseve dhe informimi i publikut të gjërë. Përderisa 75% prej tyre kane deklaruar se janë njoftuar përmes lajmeve në internet/web portale apo tv, njoftime këto të cilat mund edhe të mos jene të sakta apo plota dhe si të tilla të kenë shkaktuar edhe konfuzion apo paqartësi shtesë rreth zbatimit të GDPR.

Në mungesë të informimit të duhur dhe mirëfillte, 60% e kompanive të anketuara mendojnë se GDPR në vendin tonë është vështire i zbatueshëm apo aspak i zbatueshëm pasi që nuk jemi te anëtarësuar ende në BE. Mirëpo pavarësisht kësaj, edhe kompanitë vendore, të cilat trajtojnë apo përpunojnë te dhënat personale të qytetareve të BE-se, duhet të jenë në pajtueshmëri me GDPR. Ndërsa 40% mendojnë se GDPR duhet dhe ka mundësi të zbatimit.


Pyetja 26




Certifikimi i GDPR kundrejt vlerësimit të saj.

20% e të anketuareve parashikojnë të mbështeten në raportet e pajtueshmërisë së GDPR-së, siç janë Raporti i GDPR-së nr 30 dhe 35 për të demonstruar pajtueshmërinë e tyre. Përveç kësaj, 25% e të anketuarve nuk planifikojnë të presin për lëshimin e certifikatës zyrtare të GDPR, por në vend të kësaj do të kërkojnë të marrin një vlerësim të palës së tretë. Ndërsa pjesa tjetër prej 53% nuk janë të sigurtë se si do të dëshmojnë pajtueshmërinë e tyre me GDPR pasi që t'a arrijnë atë.

Pyetja 27



Së fundi, 67% të të anketuareve kanë deklaruar se ofrojnë shërbime apo produkte për qytetaret e BE-së, rrjedhimisht që janë të obliguar të zbatojnë GDPR në rast se mbledhin informata personale nga këta qytetare apo kompani. 27% kanë deklaruar se nuk ofrojnë shërbime apo produkte për qytetaret e BE-së, ndërsa 6% nuk janë të sigurtë nëse këta qytetare janë konsumatorë të tyre apo jo.



IV. Konkluzioni

Arritja dhe mbajtja e pajtueshmërisë së GDPR është një iniciativë e ndërlikuar dhe e kushtueshme për kompanitë e të gjitha madhësive, përgjatë gjithë shtrirjes gjeografike apo industriale.

Përderisa vetëm një përqindje e vogël (8%) ka deklaruar se është në pajtueshmëri me GDPR, pjesa tjetër beson se do arrijë këtë në një periudhë kohore prej më shumë se 1 viti.

Me ane të kësaj ankete kemi vërejtur se nevojitet informim më i gjere i publikut lidhur me rëndësinë e zbatimit të GDPR-së, fushëveprimin e saj, si dhe ndëshkimet e mundshme në rast të mos pajtueshmërisë apo shkeljes së të drejtave të qytetarëve të BE-së, të cilëve u ofrohen shërbime apo produkte.

Për MalaACG

Mala ACG është kompani e specializuar në ofrimin e shërbimeve lidhur me Auditimin, Qeverisjen dhe Menaxhimin e Sistemeve Informative, në mënyre që organizatat të arrijnë qëllimet e tyre duke shfrytëzuar këto sisteme në mënyrën e mirëfilltë, të jenë fitimprurëse, si dhe në pajtueshmëri ligjore.

Ne jemi në gjendje të analizojmë çdo aktivitet dhe të sigurojmë pjesën më të madhe të zgjidhjeve si të ulim shpenzimet tuaja, të përdorim mundësi të fshehura si dhe cilat sfera janë më të mira për investime.

Ekipi ynë i profesionistëve ka përvojë në:

- IT Auditim
- Siguri Kibernetike
- Legjislacionin
- Praktikat më të mira ndërkombëtare
- Ngritjen e kapaciteteve

Për me shume vizitoni www.mala-acg.com/blog/ apo www.mala-acg.com/GDPR

Mala ACG e përkrahur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ka realizuar këtë hulumtim i cili ka të bëjë me paraqitjen e gjendjes së zbatimit dhe gatishmërisë për pajtueshmëri me GDPR nga kompanitë vendore.